

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Nr.regj.62577/12

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqtaren Anita Nikçi- Morina dhe sekretarja juridike Sevdije Gashi, duke vendosur kundër të pandehurës Fatime Mursel Kokollari nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5 dhe neni 6 para. 1.1 të Ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollimin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar e në bazë të nenit 73,74, 195. 198 pika 8 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 18.09.2013 mori këtë.

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Fatime Mursel Kokollari nga Prishtina për veprën kundërvajtëse të paraparë në nenin 5 dhe neni 6 para. 1.1 të Ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollimin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, dhe në bazë të nenit 198 pika 8 të Ligjit për Kundërvajtje nga se e pandehura nuk ka kryer kundërvajtje që i vihet në barrë.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'i dorëzohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës

ARSYETIM

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë i parashtrroi kësaj Gjykate kërkesën me numër 01-4282-12 me date 26.11.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurës të lartëcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke kërkuar që e njëjta të shpallet përgjegjëse dhe të dënohet sipas Ligjit. Në kërkesë Agjencia Kundër Korrupsionit pretendon se e pandehura është zyrtare e lartë publik dhe se e njëjta ka patur për obligim ligjor të deklaroj pasurinë me rastin e marrjes së detyrës brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e marrjes së funksionit publik në pajtim me nenin 5 dhe neni 6 para 1.1 të Ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Gjyqtarja filloj procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurës e cila në deklaratën e dhënë pranë Gjykatës theksoi detyrën si Ushtruese e Detyrës në Klinikën e Sëmundjeve Dermatovenerologjike në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë e ka fituar më 01.10.2012. E pandehura deklaroi se lidhur me detyrimin ligjor për të deklaruar pasurinë brenda 30 ditëve nga marrja e pozitës në fjalë është njoftuar tek më 15.11.2012 nga zyrtari kontaktues z. Haki Smajli (personi të cilin institucioni ku ai punon e cakton si koordinator i punëve me Agjencinë), saktësisht me dt. 16.11.2012 kur në mbledhjen kolegjiumit profesionalë të QKU-së ishte dorëzuar një listë, ku të gjithë të pranishmit janë nënshkruar në rubriken përkatëse emrin e vet, si dëshmi e pandehura prezantoi listën në Gjykatë. E pandehura deklaroi se pas 3 ditë pas pranimit të njoftimit nga personi kontaktues ka deklaruar pasurinë. E njëjta në dëshminë e saj dhënë kësaj Gjykate deklaroi se dështimi i personit kontaktues për të informuar lidhur me detyrimet ligjore sipas Ligjit nr. 04/1-050 ka privuar atë nga mundësia për të bërë deklarimin e pasurisë në kohë, në të kundërtën deklaroi se atë detyrim do ta përmbushte në afatin ligjor. Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, Gjykata ftoi në cilësinë e dëshmitarit z. Haki Smajli (person kontaktues në QKU), i cili në dëshminë dhënë kësaj Gjykate konfirmoi se e pandehura është informuar me vonesë për detyrimin ligjor

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PRAJEN KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	
3PK/DMP		03-2831/13
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02	Data Datum Dat.
		19.09.2013

03-2891/13/02.
fey

të deklarimit të pasurisë sipas Ligjit nr. 04/1-050 me arsyetimin se fillimisht kishin ekzistuar disa paqartësi. Gjykata rikujton detyrimet ligjore të personit kontaktues në bazë të Ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, ku në nenin 4, në mes tjerash, përcaktohet se secili institucion cakton një zyrtar kontaktues i cili duhet të jetë nga Zyra e Personelit, dhe i njëjti njofton zyrtarët e lartë për deklarim të pasurisë. Gjykata vëren se neni 4 duhet parë në lidhshmëri me nenin 7 të Ligjit i cili parasheh se "me fillimin e funksionit, zyrtari i lartë publik deklaron pasurinë ekzistuese, burimin dhe detyrimet brenda afatit tridhjetë (30) ditor". Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se të pandehurës nuk mund ti atribuohet përgjegjësi kundërvajtëse për mosdeklarim me kohë të pasurisë pas marrjes së detyrës publike pasi i njëjti është notifikuar 15 ditë pas afatit të paraparë për deklarimin e pasurisë pas marrjes së detyrës sipas Ligjit Nr. 04/1-050. Gjykata çmon se Ligji Nr. 04/1-050 pëcakton qartë detyrimin ligjor të personit kontaktues për të njohtuar zyrtarisht të gjithë ata zyrtarë të lartë publik për detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë qoftë me marrjen e detyrës, deklarimin e rregullt vjetor deklarimin sipas kërkesë së Agjencisë apo deklarimin pas mbarimit apo shkarkimit nga funksion.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtroni ankesë e pandehura dhe parashtruesi i kërkesë Gjykatës së Apelit/Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

GJYQTARJA
Anita Nikçi-Morina

